L I G J
Nr.7535, datë 17.12.l991

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7174, DATË 20.11.1987 "PËR ORGANIZIMIN GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.l991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

"Gjykatat janë organe që realizojnë dhënien e drejtësisë. Ato kanë për detyrë të mbrojnë rendin kushtetues, të drejtat dhe liritë e shtetasve".

Neni 2

Neni 5 ndryshohet si vijon:

"Gjykatat gjykohen kolegjalisht, me pjesëmarrjen e ndihmësgjyqtarëve ose me një gjyqtar, sipas rregullave të vendosura në Kodin e Procedurës Penale dhe në Kodin e Procedurës Civile".

Neni 3

Paragrafi i katërt i nenit 7 ndryshohet si vijon:

"Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve dhe i ndihmësgjyqtarëve të të gjitha hallkave gjyqësore caktohet nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.

Gjyqtarët e ndihmësgjyqtarët e gjykatave të rretheve dhe të zonave, si dhe ato ushtarake emërohen e shkarkohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë".

Neni 4

Në nenin 12, pas fjalëve "e zonave" shtohen fjalët "gjykatat ushtarake".

Neni 5

Neni 16 ndryshohet si vijon:

"Gjykatat ushtarake gjykojnë në shkallë të parë veprat penale të kryera nga ushtarakët dhe veprat e tjera penale, që me ligj janë lënë në kompetencën e tyre".

Neni 6

Neni 23 ndryshohet si vijon:

"Kufijtë tokësorë të veprimtarisë se gjykatave, kur ndryshojnë nga ndarja administrative tokësore, caktohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 7

Paragrafi i dytë i nenit 27 ndryshohet vijon:

"Ministri i Drejtësisë, në raste të veçanta, mund t'i ngarkojë një gjyqtari të gjykatës së rrethit a të gjykatës ushtarake për të gjykuar në një gjykatë tjetër rrethi ose ushtarake, si dhe një gjyqtar të

gjykatës së zonës për të gjykuar në shkallë të parë çështje të gjykatave të rretheve, që përfshihen në zonën përkatëse".

Neni 8

Nenet 2, 3, 6 dhe 8 shfuqizohen.

Neni 9

Çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.96, datë 25.12.l991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.